

STATUT

I SHOQATËS

"RRJETI I FUQIZIMIT TË GRUAS NË SHQIPËRI"



Sot, më datë 02/09/2011, Themeluesit:

- Znj. Mirela Arqimandriti, lindur në Vlorë dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me nr. BA957837;
- Znj. Majlinda Hoxha, lindur në Dibër dhe banuese në Dibër, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. 027561684;
- Znj. Shpresa Banja, lindur në Durrës dhe banuese në Elbasan, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. 024700352;
- Znj. Bajana Cevoli, lindur në Lezhë dhe banuese në Durrës, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. 028581467;
- Znj. Eleni Jajçari, lindur në Pogradec dhe banuese në Pogradec madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse kartës së identitetit me nr. 028538740;
- Znj. Majlinda Agoni, lindur në Shkodër dhe banuese në Shkodër, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. 027964687;
- Znj. Brikna Puka, lindur në Vlorë dhe banuese në Vlorë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. 030268031;
- Znj. Lumturi Xhani, lindur në Vlorë dhe banuese në Sarandë , madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me nr. 028342795;

Vendosën themelimin e Shoqatës "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" në përputhje me Marrëveshjen e Bashkëpunimit si dhe me këtë Statut me terma si më poshtë:



NENI 1.
Krijimi, Baza Ligjore.

Shoqata "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, joqeveritare, jopolitike, e krijuar me vullnet të lirë të Themeluesve të saj, e cila nuk ndjek qëllime fitimi dhe është e hapur për të gjithë ata që punojnë për realizimin e qëllimeve të saj.

Shoqata "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri", krijohet dhe funksionon në përputhje me Statutin, Aktin e Themelimit, dhe legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse" (i ndryshuar).

NENI 2
Emërtimi dhe Vula

Emri i Shoqatës do të jetë "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" dhe inicialet e saj do të jenë "RRFGSH", në shqip, dhe "Albanian Woman Empowerment Network" me inicialet "AWEN" në anglisht. Këto emra do të përdoren edhe për arritjen e qëllimit të rrjetit në marrëdhënie me të tretët.

Shoqata "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" do të ketë logon dhe vulën e saj ku është shkruar në anglisht: "Albanian Woman Empowerment Network – AWEN".

NENI 3
Selia dhe territori i veprimtarisë

Selia e Shoqatës do të jetë në adresën: Rruga "Vaso Pasha", nr. 14 16, Tiranë.

Shoqata do të kryejë aktivitetin e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, si dhe jashtë territorit shqiptar në përputhje me legjislacionin përkatës vendas.

NENI 4
Afati

Shoqata "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" krijohet për një afat të pacaktuar, i cili fillon nga dita e regjistrimit të saj në Gjykatën e Tiranës.

NENI 5
Qëllimi dhe Misioni

Shoqata "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" (RRFGSH) ka si qëllim dhe mision të tij, të mbështesë, të mbrojë dhe promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nga raca, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare e filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore, si dhe për çdo shkak tjetër.

(Handwritten signatures and initials)

Qëllimi do të përmbushet nëpërmjet advokimeve dhe hulumtimeve, shkëmbimit të përvojave dhe informacionit, partneritetit dhe rrjetëzimeve dhe lobimit për respektimin e të drejtave të grave e të vajzave.

NENI 6 **Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë së organizatës "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" (RRFGSH) do të synojë të adoptojë një drejtim të përshtatshëm, si dhe masa nxitëse për të zhvilluar programe e projekte në lidhje me objektivat e poshtëshënuara:

- Të sigurojë pjesëmarrje të barabartë, efektive dhe aktive të grave dhe vajzave në zhvillimet sociale, ekonomike dhe politike në Shqipëri.
- Të advokojë, të mbrojë dhe të mbështesë të drejtat e grave në të gjitha sferat, në nivel rajonal dhe kombëtar.
- Të rrisë nivelin e pjesëmarrjes së grupeve dhe organizatave të grave në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare si dhe në angazhimet advokuese.

NENI 7 **Fondet**

Aktiviteti i Shoqatës do të financohet nga kuotat e pranimit, kuotat e anëtarësisë së anëtarëve, si dhe nga interesat që përfitohen prej depozitimit të fondeve në llogarinë bankare të Shoqatës.

Shoqata do të financohet nga donacionet e ndryshme të personave fizike a juridikë, vendas e të huaj, aktet e trashëgimisë, dhurimit, etj, si dhe nga veprimtaritë e saj të kryera në funksion të përmbushjes së qëllimit të saj.

Të gjitha të ardhurat që Shoqata do të realizojë nga veprimtaria e saj do të përdoren për realizimin e qëllimit dhe të objektivave të saj. Është e ndaluar ndarja e të ardhurave të Shoqatës midis anëtarëve të saj.

NENI 8 **ANETARËSIA – KRITERET E PRANIMIT**

Anëtarë të Shoqatës janë Themeluesit e saj. Mund të bëhet anëtar i Shoqatës "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" (RRFGSH), çdo person juridik, që ndan të njëjtat interesa me anëtarët e tjerë të shoqatës, pranon dhe zbaton qëllimet dhe objektivat e shoqatës, i cili pranohet me 2/3 e votave e anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve të shoqatës.

Personi që kërkon të anëtarësohet në Shoqatë paraqet një kërkesë me shkrim, në të cilën ai shprehet qartë se, pranon të zbatojë çdo dispozitë të këtij statuti dhe të paguajë kuotën vjetore të anëtarësisë. Kërkesa e paraqitur shqyrtohet nga Bordi Drejtues dhe paraqitet

për miratim në Mbledhjen e Përgjithshme. Pas miratimit të kërkesës, emri i anëtarit të ri regjistrohet në librin e anëtarësisë së Shoqatës.

Çdo anëtar mund të heqë dorë nga anëtarësia duke njoftuar me shkrim Bordin Drejtues.

Anëtarët mund të jenë:

- Anëtarë, që përfshijnë të hémeluesit dhe të gjithë ata që pranohen në vijim si anëtarë të shoqatës.
- Anëtarët e shoqatës duhet të paguajnë kuotën fillestare të anëtarësisë dhe kuotën vjetore të qenies anëtar i shoqatës.
- Anëtarë nderi, që përfshijnë individë, ose persona juridikë, ente apo institucione private apo publike, të cilët kanë kontribuar në mënyrë thelbësore në themelimin, apo në jetën dhe veprimtarinë e Shoqatës. Këta anëtarë kanë karakter të përhershëm dhe janë të përjashtuar nga detyrimi për pagesat e kuotizacioneve.

Numri i anëtarëve dhe anëtarëve të nderit është i pakufizuar. Të gjitha anëtarët dhe anëtarët e Nderit kanë të drejtë të marrin pjesë në Mbledhjet e Përgjithshme, kanë të drejtë vote, dhe kanë të drejtë të zgjidhen në organet drejtuese të Shoqatës. Çdo anëtar ka të drejtën e një vote.

Anëtarët e shoqatës janë të detyruar:

- Të paguajnë rregullisht kuotën e anëtarësisë në vlerën 200 lekë dhe atë vjetore në vlerën 500 Lekë në vit;
- Të marrin pjesë në aktivitetet që organizon shoqata;
- Të japin ndihmë konkrete aktive në zbatimin e programit të aktiviteteve të shoqatës;
- Anëtari duhet të paguaje rregullisht kuotën e anëtarësisë dhe të mos kryejë asnjë veprim që në mënyrë direkte apo indirekte dëmton interesat e Shoqatës.

NENI 9

Humbja e statusit të anëtarësisë

Anëtarët e Shoqatës mund të humbasin cilësinë si të tillë, kur:

- a. Heqin dorë;
- b. Mbaron së ekzistuari "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" (RRFGSH);
- c. Përjashtohen nga anëtarësia.

Bordi Drejtues mund të vendosë në çdo moment për përjashtimin e Anëtarit për një nga motivet e mëposhtme:

- a. Moszbatim i dispozitave të Statutit;
- b. Vazhdimi i anëtarësisë së tij ndalohej me ligj;
- c. Anëtari shkel parimet bazë të funksionimit të Shoqatës;

[Handwritten signatures and stamps]

- d. Mospërbushja e njërit prej detyrimeve kontraktore ndaj të tretëve në një marrëveshje për të cilin anëtari ka kërkuar bashkëpunimin, ndërhyrjen ose ndihmën e Shoqatës, që në mënyrë të heshtur ka garantuar korrektësinë e tij (Anëtarit).

Kundër vendimit të Bordit drejtues në bazë të paragrafit të dytë të këtij neni, anëtari i përjashtuar, paraqet ankim në Mbledhjen e Përgjithshme, e cila vendos me shumicën e anëtarëve të pranishëm.

Anëtarët që heqin dorë nga anëtarësia duhet të njoftojnë vendimin e tyre të paktën 3 muaj para mbarimit të vitit kalendarik.

NENI 10

Organet drejtuese të Shoqatës

Organet drejtuese të "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" (RRFGSH) janë:

1. Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve të Shoqatës (Mbledhja e Përgjithshme);
2. Bordi Drejtues;
3. Drejtori ekzekutiv;
4. Sekretari i Përgjithshëm;

NENI 11

Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve

Mbledhja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqatës.

Mbledhja e përgjithshme formohet nga të gjithë anëtarët e shoqatës.

Mbledhja e Përgjithshme mbledhet në seancë të zakonshme të paktën një herë në vit.

Mbledhja e Përgjithshme e thirrur rregullisht, përfaqëson tërësinë e anëtarëve dhe vendimet e marra prej saj bazuar në ligj dhe në këtë Statut, janë të detyrueshme për të gjithë Anëtarët, pavarësisht nëse nuk janë të pranishëm, ose kanë mendim të kundërt.

Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve thirret me iniciativë të Bordit Drejtues me kërkesë me shkrim, ose kur kërkohet prej të paktën 1/8 së anëtarëve.

Mbledhja e Përgjithshme mund të mbledhet në seanca të jashtëzakonshme kur e kërkon Kryetari i Bordit Drejtues ose të paktën 1/5 e të gjithë anëtarëve të Shoqatës..

Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve mbledhet në selinë e Shoqatës ose në një vend tjetër si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

Mbledhja e Përgjithshme ka këto kompetenca:

- a. Përcakton fushat e programet e veprimtarisë së Shoqatës dhe mënyrën e realizimit të këtyre programeve;
- b. Emëron dhe shkarkon anëtarët e Bordit dhe sekretarin e përgjithshëm;
- c. Aprovon buxhetin vjetor të Shoqatës dhe shqyrton të gjitha çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit të pasurisë dhe objekteve pasurore të shoqatës;
- d. Mbikëqyr dhe kontrollon rregullisht ushtrimin e detyrave të Bordit Drejtues në lidhje me administrimin e veprimtarisë së Shoqatës, si dhe me shqyrtimin e

[Handwritten signatures in blue ink]

- çështjeve ekonomike, financiare dhe administrative të Shoqatës;
- e. Vendos për ndryshimin e Statutit të Shoqatës sipas kuorumit të përcaktuar në Ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jo-fitimprurëse" (i ndryshuar);
 - f. Nxjerr akte për rregullimin e veprimtarisë, të organizimit dhe të funksionimit;
 - g. Vendos shpërndarjen e Shoqatës dhe cakton likuidatorin për zhvillimin e procedurës së likuidimit të organizatës.
 - h. Krijon komisione ose organizma në varësi të veprimtarisë së Shoqatës.
 - i. Ushtron çdo kompetencë tjetër që asaj i njihet nga ligji.
 - j. Vendos për pranimin ose jo, të ndihmave dhe donacioneve që i jepen Shoqatës;
 - k. Vendos për tërheqjen e burimeve për promovimin e aktivitetit të Shoqatës;
 - l. Merr vendime për krijimin e organizatave të tjera, ose pjesëmarrjen në to;
 - m. Kryen miratimin për fondet dhe buxhetin e shoqatës dhe të shpenzimeve për vitin e ardhshëm, miratimin ose jo të llogarive financiare dhe raporteve vjetore për vitin paraardhës, brenda 4 muajve të atij viti, si dhe për buxhetin vjetor për vitin pasardhës të paktën 2 (dy) muaj përpara fillimit të atij viti;
 - n. Emëron një Ekspert Kontabël të Autorizuar për auditimin e llogarive vjetore të Shoqatës.

Mbledhja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme e Anëtarëve:

- a. vendos për ndryshimet e Statutit;
- b. vendos mbi emërimin dhe kompetencat e likuidatorëve;

NENI 12

Procedurat dhe vendimet e mbledhjeve

Mbledhja e Përgjithshme, thirret 2 herë në vit. Kur thirret për herë të parë i zhvillon punimet nëse janë të pranishëm/ose të përfaqësuar, më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve. Në mbledhjen e dytë, mjafton të jenë prezent një numër i çfarëdoshëm i Anëtarëve.

Mbledhja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme e Anëtarëve, si në thirrjen e parë dhe atë të dytë kërkon që të jenë prezent dhe/ose të përfaqësuar $\frac{3}{4}$ e Anëtarëve të "Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" (RRFGSH).

Në rast të një vendimi që merret për shpërndarjen e Shoqatës, duhet të jenë prezent të paktën $\frac{2}{3}$ e Anëtarëve në thirrjen e parë dhe shumica e Anëtarëve në thirrjen e dytë. Si në thirrjen e parë ashtu edhe në të dytën, vendimet merren me miratimin e shumicës së Anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

Anëtarët kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve në Gjykatën kompetente, brenda një muaji nga marrja dijeni e tyre.

NENI 13



Njoftimi për Mbledhjen e Përgjithshme të Anëtarëve

1. Anëtarët duhet të lajmërohen 15 ditë përpara datës së caktuar për takimin e Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve.
2. Lajmërimi duhet të përmbajë rendin e ditës për çështjet që do të trajtohen, ditën, orën dhe vendin e mbledhjes, si dhe datën e mbledhjes së dytë të mundshme, që s'mund të mbledhet pa kaluar të paktën 30 ditë nga data e mbledhjes së parë.
3. Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Mbledhjes së Përgjithshme, i cili zgjidhet me shumicë të thjeshtë votash ndërmjet tyre.
4. Procesverbali i mbledhjes mbahet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe i shtrohet për miratim Mbledhjes së Përgjithshme në mbledhjen e saj të ardhshme.
5. Komunikimi i njoftimeve kryhet nëpërmjet postës së shkruar ose nëpërmjet postës elektronike.

NENI 14
Përfaqësimi dhe votimi

Secili anëtar në Mbledhjen e Përgjithshme ka të drejtën e një vote të vetme. Është e vlefshme vota e dërguar me postë të shkruar.

Anëtarët që nuk kanë mundësi të marrin pjesë në Mbledhjen e Përgjithshme, mund të përfaqësohen nga një tjetër anëtar me attribute të plota, vetëm përmes delegimit me shkrim.

Asnjë anëtar nuk mund të përfaqësojë më shumë se një anëtar tjetër.

Anëtarët e Bordit Drejtues nuk mund të përfaqësojnë anëtarë të tjerë.

NENI 15
Bordi Drejtues

Bordi Drejtues është organi që administron Shoqatën në bazë të vendimeve dhe drejtimeve të përcaktuara me vendim të Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve.

Bordi drejtues përbëhet nga 7 anëtarë, 3 prej të cilëve zgjidhen nga radhët e themeluesve të shoqatës, ose përfaqësuesve të tyre që janë anëtarë të Mbledhjes së Përgjithshme të shoqatës. Katër anëtarë të Bordit, zgjidhen me kusht që të mos jenë anëtarë të Mbledhjes së Përgjithshme të Shoqatës, por bashkëpunëtorë të jashtëm të saj.

Anëtarët e Bordit emërohen nga Mbledhja e Përgjithshme dhe qëndrojnë në detyrë, si rregull për katër vjet me të drejtë rizgjedhjeje. Tre anëtarët e e për zgjedhur nga organet e brendshme të shoqatës, i nënshtrohen rrotacionit, çdo vit.

Bordi Drejtues zgjedh midis anëtarëve të tij Presidentin dhe një Zv. President. Mandati i tyre korrespondon me mandatin përkatës si anëtarë.

Presidenti i parë i Bordit do të zgjidhet me afat 1 (një) vjeçar.

(Handwritten signatures in blue ink)



NENI 16

Njoftimi dhe vlefshmëria e Mbledhjes së Bordit Drejtues

Bordi Drejtues thirret nga Presidenti dhe në rast se ka një kërkesë të arsyetuar nga çdo anëtar i Shoqatës. Lajmërimi i anëtarëve bëhet nëpërmjet komunikimit me shkrim, dhe postës elektronike.

Të gjithë anëtarët e Bordit duhet të konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në Mbledhjen e Bordit jo më vonë se një ditë pas njoftimit për takim.

Bordi drejtues duhet të mbledhet të paktën një herë në tre muaj.

Mbledhjet e Bordit janë të vlefshme vetëm nëse në to merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve.

Në rast barazie midis votave, konfliktin e zgjidh vota e Presidentit.

Anëtari i Bordit që ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen që diskutohet duhet të heqë dorë nga pjesëmarrja në diskutime dhe në votim.

NENI 17

Kompetencat e Bordit Drejtues

Bordi Drejtues ka të gjitha kompetencat që nuk i rezervohen posaçërisht Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve të Shoqatës, dhe konkretisht:

- Kryen administrimin e "Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" (RRFGSH) dhe vendos për çështje që lidhen ngushtë me funksionimin e tij, sipas përcaktimeve të legjislacionit shqiptar.
- Përcakton në mënyrë të detajuar rast pas rasti (sipas projekteve që zbatohen), marrëdhënien e Shoqatës "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" me anëtarët themelues, për çdo rast, mbi bazën e marrëveshjes që do të lidhet ndërmjet tyre, për projekte/kontrata në të cilat "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" (RRFGSH) është palë.
- Përgjigjet para Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve për punën e organeve ekzekutive dhe është përgjegjës para të tretëve dhe para autoriteteve shtetërore për shkeljet eventuale të dispozitave ligjore dhe statutores.
- Drejton veprimtarinë e Shoqatës në përputhje me statutin dhe vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme;
- Përgatit planin vjetor të punës, planin buxhetor dhe ia paraqet atë Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve për miratim dhe kontrollon zbatimin e tyre.
- Mbikëqyr me veprimtarinë e përditshme të Shoqatës, si dhe kryen detyra të tjera të veçanta sipas vendimeve të Mbledhjes së Përgjithshme.
- Harton programin e aktiviteteve të Shoqatës dhe ia paraqet atë për miratim Mbledhjes së Përgjithshme.

- h. Cakton delegacionet për aktivitete të ndryshme brenda e jashtë vendit, si dhe koordinon veprimet me organizatat e tjera homologe.
- i. Kujdeset për mbajtjen në minimum të shpenzimeve të Shoqatës;
- j. Bordi mbledhet jo më pak se katër (4) herë në vit, ose kur kërkohet nga, të paktën 1/3 e anëtarëve të tij. Mbledhjet e Bordit zhvillohen kur në të marrin pjesë jo më pak se 2/3 e anëtarëve.
- k. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash. Në rast numri votash të barabarta, vota e Presidentit do të jetë vendimtare;
- l. Bordi përcakton kriteret dhe procedurat për administrimin e fondeve, donacioneve që do të shërbejnë për aktivitetet dhe plotësimin e misionit tyre;
- m. Bordi emëron Drejtorin Ekzekutiv, mbikëqyr punën e tij dhe përcakton me kontratë kushtet dhe kompetencat e tij.
1. Kujdeset për plotësimin e vendeve që për një arsye ose një tjetër mbeten bosh deri sa të mbledhet Mbledhja e ardhshme e Përgjithshme.
- f. Vendos për masat për përjashtim apo pushim të anëtarëve, duke u kujdesur për procedurën e ankimeve.

Anëtari i Bordit që pa një motiv të justifikuar nuk merr pjesë në 3 (tre) mbledhje të njëpasnjëshme, mund të deklarohet i hequr, dhe Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve ka të drejtë të fillojë procedurat për zëvendësimin e tij.

Anëtari i Bordit që zëvendëson atë të hequr, do ta mbajë këtë post deri në mbarim të mandatit të anëtarëve të tjerë të Bordit.

NENI 18

Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv ka këto kompetenca:

- a. Kryen detyrat e tij bazuar në profilin e punës të përcaktuar nga Bordi Drejtues dhe Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve;
- b. Ai/Ajo përgatit buxhetin dhe organizon aktivitete financiare dhe aktivitete të tjera të cilat aprovohen nga Bordi i Drejtues;
- c. Ai ka të drejtë të nënshkruajë e vulosë çdo dokument në emër të Shoqatës.
- d. Ka të drejtë të hapë llogari bankare në emër të shoqatës dhe të kryejë ose arkëtojë vetë pagesa me miratimin e Bordit Drejtues.
- e. Në përputhje me rregullat e brendshme, merret me korrespondencën që ka të bëjë me problemet organizative dhe administrative;
- f. Kujdeset për përcjelljen e dokumentacionit të kërkesave të reja për anëtarësim në Shoqatë, pranë Mbledhjes së Përgjithshme dhe Bordit Drejtues;
- g. Emëron dhe mund të shkarkojë të punësuarit me miratimin e Bordit Drejtues, vendos marrëdhënie kontraktuale me nën-kontraktorët në përputhje me strukturën/përcaktimet e vendosura nga Bordi Drejtues;
- h. Kontrollon zbatimin e vendimeve të Bordit Drejtues dhe respektimin e dispozitave statutore dhe ligjore;
- i. Kontrollon funksionimin e shërbimeve dhe të zyrave.

[Handwritten signatures and initials in blue ink]

Drejtori Ekzekutiv merr vendimet e përditshme të drejtimit të Shoqatës në përputhje me prioritetet e caktuara nga Bordi i Drejtorëve.

Ai/Ajo përgatit brenda 4 muajve pas përfundimit të vitit financiar, raportin vjetor dhe llogaritë financiare përsa i përket vitit të fundit financiar të Shoqatës dhe ia paraqet ato një eksperti kontabël të caktuar nga Mbledhja e Përgjithshme e Anëtarëve.

Drejtori Ekzekutiv miradministron mjetet në pronësi të Shoqatës.

Të gjitha rregullat e tjera për kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv dhe marrëdhëniet e tij me Bordin Drejtues do të rregullohen nga Rregullorja e Brendshme e Shoqatës.

NENI 19

Sekretari i Përgjithshëm

Sekretari i Përgjithshëm është organi përgjegjës për asistencën, regjistrimin dhe zbardhjen e procesverbaleve të mbledhjeve të Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve dhe përgjigjet vetëm përpara tij.

NENI 20

Përfaqësimi i Shoqatës.

Drejtori Ekzekutiv është përfaqësuesi ligjor i Shoqatës si dhe Ai/Ajo ka të gjitha kompetencat dhe autoritetin për të përfaqësuar Shoqatën:

a. për firmosjen e akteve dhe kontratave të hartuara nga organet vendimore me palët e treta;

b. përpara organeve gjyqësore;

c. administratës publike apo enteve të tjera publike dhe private.

2. Drejtori Ekzekutiv ushtron pushtetet e tij, të cilat i janë atribuuar nga ana e Bordit Drejtues, si gjatë administrimit të zakonshëm ashtu dhe gjatë administrimit të jashtëzakonshëm.

NENI 21

Buxheti dhe Raporti Vjetor

Drejtori Ekzekutiv duhet t'i paraqesë Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve, të paktën 2 muaj përpara fillimit të vitit përkatës, planin vjetor buxhetor, dhe planin vjetor të punës dhe merr miratim paraprak për zbatimin e tyre.

Ai i paraqet Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve dhe ekspertit kontabël të caktuar prej saj, brenda 4 muajve pas përfundimit të vitit financiar përkatës, raportin vjetor dhe llogaritë financiare të Shoqatës përsa i përket vitit më të fundit financiar.

NENI 22

Iniciativat dhe marrëdhëniet me të tretët



Shoqata "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" ka të drejtën të hyjë në marrëdhënie kontraktuale ekonomike, social-kulturore etj. me persona juridikë ose fizikë, të huaj apo vendas, për të ndërmarrë individualisht apo në mënyrë kolektive (në bashkëpunim me organizata të tjera), iniciativa të cilat nuk bien ndesh me qëllimet e vetë Shoqatës, Statutin, Rregulloren e Brendshme dhe legjislacionin në fuqi.

Detyrimet e Shoqatës "Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri", të marra përsipër në bazë të kontratave që ajo ka nënshkruar në emër të Shoqatës me palët e treta, mund t'i delegohen me një marrëdhënie kontraktore, organizatave në të cilat militojnë anëtarët themelues, të cilat nga ana e tyre duhet të respektojnë detyrimet e parashikuara në kontratën e lidhur ndërmjet tyre dhe Rrjetit.

NENI 23

Llogaria Bankare

Fondet e buxhetit të Shoqatës derdhen në llogarinë që ajo hap në një nga bankat me seli në Republikën e Shqipërisë. Shoqata në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe për realizimin e qëllimeve të aktivitetit të tij ka të drejtë të transferojë para jashtë shtetit.

NENI 24

Pavlefshmëria e veprimeve

Detyrimet (borxhet) e anëtarit të Shoqatës nuk rëndojnë mbi pasuritë dhe të drejtat e Shoqatës.

Çdo veprim, që bie ndesh me statutin dhe Rregulloren e Brendshme nuk ka vlerë juridike për Shoqatën.

Dokumentet që nuk përmbajnë vulën e Shoqatës dhe/ose firmën e personit të autorizuar sipas Statutit të Shoqatës për të firmosur në emër të tij, ose që nuk janë përpiluar në përputhje me rregullat statutores, janë të pavlefshme.

Shoqata nuk mban përgjegjësi për veprimet individuale të organizatave që bëjnë pjesë dhe janë anëtare në "Rrjetin e Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" dhe/ose në kundërshtim me statutin.

NENI 25

Shpërndarja e fitimeve

Shoqata e ka të ndaluar shpërndarjen e fitimeve tek themeluesit apo anëtarët, të cilët nga ana e tyre nuk kanë të drejtë të kërkojnë shpërndarjen e fitimeve.

NENI 26

Shpërndarja e Likuidimi i Shoqatës

Shoqata e ndërpret veprimtarinë e saj kur:

1. numri i anëtarëve zbret nën numrin minimal të anëtarëve të përcaktuar nga legjislacioni shqiptar;

2. organizata e ka përbushur qëllimin dhe objektivat e saj;
3. ne te gjitha rastet e tjera kur parashikohet me ligj.

Vendimi për shpërndarjen e Shoqatës merret nga Mbledhja e Përgjithshme. Ne këtë mbledhje caktohet edhe likuidatori i Shoqatës. Likuidimi i Shoqatës dhe destinimi i pasurisë pas mbarimit të organizatës, do të behet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 27

Emërimet

Emërimet në organet e para drejtuese të shoqatës janë:

Bordi Drejtues, i cili përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë vijon:

1. Eglantina Gjermeni (deputete, politikane)
2. Delina Fico (aktiviste, eksperte për të drejtat e njeriut)
3. Gazmend Oketa (deputet)
4. Aleksander Çipa (Gazetar)
5. Mirela Arqimandriti (Drejtoreshë Ekzekutive, Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim, Tiranë)
6. Bajana Çeveli (Drejtoreshë Ekzekutive, Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës)
7. Eleni Jajçari (Drejtoreshë Ekzekutive, Shoqata "Unë Gruaja", Pogradec)

Drejtori Ekzekutiv Znj. Ines Xhelili (Leskaj)

NENI 28

Dispozita e fundit

Për çdo gjë e cila nuk është parashikuar në këtë Statut, apo në Rregulloren e Brendshme do i referohet legjislacionit në fuqi dhe veçanërisht ligjit nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse" (i ndryshuar) dhe ligjit nr.8789, datë 07.05.2001, "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse".

Marrëveshja e Themeluesve do t'i bashkëngjitet këtij Statuti dhe do të jetë pjesë integrale e tij.

Ky statut hartohet në 14 kopje të njëjta, në gjuhën shqipe. Themeluesit, pasi e gjejnë atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë e nënshkruajnë atë pa vërejtje

[Handwritten signatures and initials in blue ink]




ANËTARËT THEMELUES

Mirela Arqimandriti 


Majlinda Agoni 

Brikena Puka 

Lumturi Khani 

Majlinda Hoxha 

Shpresa Banja 

Bajana Cevoli 

Eleni Jajçari 

REPubLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE MIMOZA R. SHEHU
NR. 9409 PER.
NR. 7960 KOL

VERTETIM

Sot me daten 12.12.2011 ne zyren e Noterise Tirane, perpara meje Noteres Mimoza R. Shehu Notere e Dhomes se Noterise irane, u paraqiten personalsht personat si me poshte

Znj. Mirela Arqimandriti, lindur ne Vlore dhe banuese ne Tirane, madhore me zotesi te plotë juridike per te vepruar, mbajtese e pasaportes me nr. BA957837;

Znj. Majlinda Hoxha, lindur ne Diber dhe banuese ne Diber, madhore me zotesi te plotë juridike per te vepruar, mbajtese e kartes se identitetit me nr. 027561684;

Znj. Shpresa Banja, lindur ne Durrës dhe banuese ne Elbasan, madhore me zotesi te plotë juridike per te vepruar, mbajtese e kartes se identitetit me nr. 024700352;

Znj. Bajana Cevoli, lindur ne Lezhe dhe banuese ne Durrës, madhore me zotesi te plotë juridike per te vepruar, mbajtese e kartes se identitetit me nr. 028581467;

Znj. Eleni Jajçari, lindur ne Pogradec dhe banuese ne Pogradec madhore me zotesi te plotë juridike per te vepruar, mbajtese kartes se identitetit me nr. 028538740;

Znj. Majlinda Agoni, lindur ne Shkoder dhe banuese ne Shkoder, madhore me zotesi te plotë juridike per te vepruar, mbajtese e kartes se identitetit me nr. 027964687;

Znj. Brikena Puka, lindur ne Vlore dhe banuese ne Vlore, madhore me zotesi te plotë juridike per te vepruar, mbajtese e kartes se identitetit me nr. 030268031;

Znj. Lumturi Xhani, lindur ne Vlore dhe banuese ne Sarande, madhore me zotesi te plotë juridike per te vepruar, mbajtese e pasaportes me nr. 028342795;

Te cilat deklaruan se akti sa siper eshte redaktuar sipas vullnetit te tyre e nenshkruan ne pranine time dhe une noterja legalizoj nenshkrimet sipas ligjit.

The image shows a circular official notary seal of the Republic of Albania, Tirane, with the name 'MIMOZA R. SHEHU' and the number '127125'. Overlaid on the seal is a large, stylized blue ink signature. To the right of the seal, there is a rectangular stamp containing the name 'Mimoza R. Shehu' and the number '127125' in blue ink.